



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_263\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_417\_05\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_417\_05\_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Ruzhdi Zogaj (shifra e konsumatorit DPR – 200986) nga Drenasi, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 14.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 23.12.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 14.11.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për kontrollin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se nuk mund të merret gjendja e njehsorit pasi që tabela e njehsorit ka rënë.

**Provë:** Procesverbali i kontrollës nr. 022833 të datës 14.11.2007

- Me datë 03.12.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 11624351 dhe ka vendosur për matje njehsorin nr. 10798703.

**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 1923 i datës 03.12.2007

- Me datë 27.12.2007 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 11624351, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar, tabela e njehsorit nuk është në vendin e vet si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 11/27 i datës 27.12.2007
- Me datë 14.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtimin e njehsorit kanë bërë shqyrtimin mbi saktësinë e matjes së njehsorit elektrikë me nr. 11624351.  
**Provë:** Protokoll i mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 02/106 i datës 14.01.2008
- Me datë 26.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe regjistrimin e pajisjeve që posedon konsumatori.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0122866 i datës 26.03.2008
- Me datë 07.04.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP05095 në vlerë prej 841.80 €.  
**Provë:** Fatura DPR08HP05095 e datës 07.04.2008
- Me datë 19.11.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 23.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 23.12.2009
- Me datë 14.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_417\_05\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar